



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Ministria e Drejtësisë**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**  
**Ministria e Drejtësisë**

## DEKLARATË E PËRBASHKËT

### E MINISTRAVE TË DREJTËSISË TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Ministrat e Drejtësisë së Republikës së Kosovës Albulena Haxhiu dhe Ulsi Manja Republikës së Shqipërisë.

Duke rikonfirmuar vullnetin dhe angazhimin e përbashkët politik për të forcuar kuadrin e bashkëpunimit në fushën e drejtësisë, të dy vendeve tona me synim krijimin e një hapësire të lirë ndërveprimi për njerëzit, idetë, kapitalet, tregtinë dhe inovacionin, si dhe çdo fushë tjetër me interes të përbashkët,

Bazuar në Deklaratën e Përbashkët për Bashkëpunim dhe Partneritet Strategjik, nënshkruar në Prizren në vitin 2014; në Deklaratën e Përbashkët në Fushën e Zhvillimit Rajonal në Zonat Ndërkufitare Shqipëri-Kosovë, nënshkruar në Tiranë në vitin 2015, si dhe në numrin e konsiderueshëm të marrëveshjeve, memorandumeve e protokolleve të bashkëpunimit nënshkruar që nga mbledhja e Prizrenit, ne kemi krijuar një bazë të rëndësishme e të konsoliduar për ndërtimin e politikave të përbashkëta në fusha të ndryshme,

Duke konstatuar me kënaqësi se të dy vendet tona kanë përparuar dhe janë në një stad të ri e më të lartë në bashkëpunimin dypalësh, në fushën e drejtësisë, në zgjerimin dhe intensifikimin e bashkëpunimit në fushën penale

Duke përshëndetur hyrjen në fuqi më 30 Qershor 2022 të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës “Për ndihmë të ndërsjellët juridike në çështjet civile dhe tregtare”, me të cilën plotësohet boshllëku ligjor i bashkëpunimit dypalësh në fushën civile, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të gjykatave respektive, njoftimin e akteve, marrjen e provave, thirrjen e subjekteve, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve, i cili do zbatohet për marrëdhënie të tilla si marrëdhëniet civile, tregtare, familjare, trashëgimie, pune, pronësie, etj., marrëveshje që në analizë të fundit garanton qasjen në drejtësi,

Duke konfirmuar faktin se Shqipëria, nga ana e saj, po përparon në mënyrë të qenësishme drejt rrugëtimit evropian dhe në këtë drejtim ka fokusuar energjitë, në nivel kombëtar, për realizimin e reformave dhe

përgatitjen e hapave të ardhshëm në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, dhe Ministria e Drejtësisë ka rol drejtues për kapitullin 23 dhe kontribuues në nënkaptullin "Për bashkëpunimin gjyqësor në fushën civile dhe penale" të kapitullit 24, dhe duke njohur përkushtimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për reformat në drejtësi dhe duke qenë të bindur që keto reforma do të avansojnë sundimin e ligjit, demokracinë dhe të drejtat e njeriut."

Të ndërgjegjshëm se Shqipëria dhe Kosova kanë ende hapësira të pashfrytëzuara në funksion të zhvillimit të gjithanshëm, na del si detyrë parësore të bëjmë përpjekjet maksimale e sa më konkrete për t' i shfrytëzuar ato për të përmirësuar jetën e qytetarëve tanë;

Të vetëdijshëm për arritjet e deritanishme dhe në zbatim të marrëveshjeve të arritura;

Biem dakord, në emër të qeverive tona, të ndërmarrim iniciativa dhe angazhime konkrete, si më poshtë:

1. Hartimin, negocimin dhe nënshkrimin e Marrëveshjes Dypalëshe për njohjen dhe zbatimin e vendimeve alternative;
2. Hyrjen në reciprocitet përmes shkëmbimit të deklaratave të reciprocitetit për fushat e:
  - a) Avokatisë;
  - b) Ndërmjetësim;
  - c) Njohjen e provimit të jurisprudencës.
3. Hartimin dhe nënshkrimin e një Memorandum Bashkëpunimi ku të parashikohet ngritja e një mekanizmi për zbatimin, ndjekjen dhe realizimin e marrëveshjeve dhe të gjitha angazhimeve të marra deri më tani midis dy ministrive respektive;
4. Përpilimin e një liste projektsh të përbashkëta për zhvillimin dhe bashkëpunimin në fushën e drejtësisë;
5. Krijimin brenda muajit qershor 2023 të një mekanizmi ndërinstytucional planifikimi dhe identifikimi për projektet rajonale në fushën e drejtësisë midis Shqipërisë dhe Kosovës
6. Angazhimin për identifikimin e burimeve financiare të përbashkëta nga të tretët për realizimin e projekteve të përbashkëta në kuadrin e bashkëpunimit gjyqësor, sistemit gjyqësor, sistemit penitenciar.

Nënshkruar në Prishtinë më 20 qershor 2022, në dy origjinalë në gjuhën shqipe.

MINISTRI I DREJTËSISË

MINISTRI I DREJTËSISË

I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Albulena Haxhiu

Ulsi Manja